



# ERMANDA MUSOLLARI

## Avancimi në Karrierë pas Trajnimeve në Sigurinë Kibernetike

Ermanda Musollari, një inxhinierë 28-vjeçare nga Tirana, ka avancuar në karrierën e saj pas pjesëmarrjes në trajnime të sigurisë kibernetike të organizuara nga FISA me mbështetjen e RisiAlbania.

Ajo tregon se këto trajnime i kanë dhënë aftësi të avancuara dhe një rrjet profesionistësh në fushën e sigurisë kibernetike. Aktualisht, ajo punon si inxhinierë e sigurisë kibernetike dhe menaxhon projekte në këtë fushë.



Një projekt nga Agjencia Zvicerane për  
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:



*“Kam marrë pjesë në eventet si “Youth Talk Albania” dhe “Youth Employment ICT Cybersecurity” nëpërmjet kompanisë ku unë punoj, Fisa Academi. Kompania ime bashkëpunon me RisiAlbania në projektin Capacity Buildings. Qëllimi im ishte të fitoja njohuri të reja dhe aftësi praktike në fushën e ICT-së dhe Cybersecurity, si dhe të zhvilloja karrierën time profesionale në këtë sektor”.*



## **Për çfarë e ndihmoi trajnimi specifikisht?**

Ajo shpjegon se e ndihmoi në përvetësimin e aftësive të avancuara në fushën e cybersecurity, si dhe e ndihmoi shumë për të ndërtuar një rrjet profesionistësh në këtë fushë. Kur e pyet se sa vlerë pati më pas, ajo shprehet *“shumë”*, duke përfunduar mirënjohjen e saj se si aftësitë dhe njohuritë që fitoi e ndihmuan të avancojë në pozicionin e saj aktual në kompani dhe të kontribuojë me efikasitet në projektet e sigurisë kibernetike.

Ermanda ka ndjekur trajnimet e FISA-s mbi sigurinë kibernetike dhe më pas është punësuar tek kjo Akademi. Kurset e Fisa Academi kanë luajtur një rol të jashtëzakonshëm në zhvillimin e karrierës së saj në fushën e sigurisë së informacionit. Ermanda, duke qenë e përqendruar në ekipin e Blue Team në Cybersecurity, kurset e tyre të specializuara për këtë aspekt i kanë ofruar një bazë të thellë të njohurive. Në veçanti, kurset respektive si CompTIA A+, CIRT dhe InfoSec Threats dhe Vulnerability Assessment kanë zhvilluar aftësitë teknike dhe aftësitë për të adresuar sfidat në fushën e sigurisë. Përvoja e Ermandës përfshin trajnime të specializuara për monitorimin e sigurisë dhe menaxhimin e incidenteve në IT. Kjo jo vetëm që i ka rritur kompetencat teknike, por gjithashtu e ka pajisur me njohuri të rëndësishme për standardet e sigurisë si ISO 27001, duke i lejuar të kontribuojë në zbatimin e tyre në kompaninë ku punon. Për të ardhmen, ajo është e gatshme të përballet me sfidat e mëdha në këtë fushë duke përdorur njohuritë dhe aftësitë e fituara.

*“Konkretisht, përmirësova njohuritë e mia teknike në lidhje me identifikimin dhe menaxhimin e kërcënimeve kibernetike, si dhe zhvillova aftësi të reja në zgjidhjen e problemeve komplekse në këtë fushë. Dhe, padyshim që do të merrja sërish pjesë në këto trajnime nëse do më jepej mundësia, pasi ishte një eksperiencë shumë e vlefshme dhe e dobishme për zhvillimin tim profesional”,* tregon Ermanda.

Aktualisht ajo punon si Inxhinier Cybersecurity prej një viti dhe gjithashtu menaxhon projekte në fushën e Cybersecurity në Fisa Academi. Pritshmëritë e saj u përmbushën plotësisht. Fitoi njohuri dhe aftësi të reja që e zhvilluan profesionalisht për t'u stimuluar me qëllime të reja në karrierë.

FISA Academy, një degë e kompanisë First Group e themeluar në vitin 2008, është specializuar në ofrimin e sistemeve të integruara për sigurinë kibernetike. Akademia u themelua në vitin 2021 si përgjigje ndaj kërkesës në rritje të tregut të ICT për çështjet e sigurisë kibernetike. Ky qendër trajnimi u krijua natyrshëm, si pjesë e grupit FIRST, për të plotësuar nevojën për profesionistë në fushën e Sigurisë Kibernetike. Qëllimi ishte krijimi i një rrjeti profesionistësh dhe forcimi i zinxhirit të vlerave njerëzore dhe potencialit të ekspertëve në këtë fushë, duke ndihmuar kështu bizneset dhe agjencitë qeveritare të rrisin kapacitetet e profesionistëve në këtë fushë.

Projekti RisiAlbania ka mbështetur FISA në zhvillimin e një hulumtimi mbi kërkesën dhe ofertën së tregut për punonjës të sigurisë kibernetike, rritja e kapaciteteve të instruktorëve të FISA përmes trajnimit të instruktorëve (TOT), zhvillimi i kurrikulave të reja mbi sigurinë kibernetike dhe organizimi i hackathon-it të FISA mbi këtë temë.

